



|                                                                                     |                                          |
|-------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO                             |                                          |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |                                          |
| Dep.<br>Dep. <b>2-D/DPK</b>                                                         | Nr. Prot.<br>Br. Prot. <b>01-2901/15</b> |
| Nr. l faq.<br>Broj stranica<br>Nr. pages <b>02</b>                                  | Data<br>Datum<br>Date <b>25-09-2015</b>  |
| PRISHTINE                                                                           |                                          |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.09.2015, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 - 02-2496/15, për znj. Margarita Kadriu - Ukelli, Deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtarja e lartë publike ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK - 03 -02 - 2496/15, për zyrtaren e lartë znj. Margarita Kadriu - Ukelli - Deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

Zyrtarja e lartë znj. Kadriu - Ukelli është hetuar për konflikt interesi sepse krahas ushtrimit të funksionit publik si deputete, ka qenë person i autorizuar në tri biznese private: "Forum Kosova Investments" Sh.P.K., "Forum Kosova Invest" Sh.P.K. dhe "Interpress R. Company" Sh.P.K.

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) fillimisht i ka dërguar shkresën zyrtare - njoftim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës zyrtarja e lartë është takuar me zyrtarët e Agjencisë.

Në takim znj. Kadriu - Ukelli është njoftuar me kufizimet në ushtrimin e funksioneve menaxheriale, krahas ushtrimit të funksionit publik, si dhe për ndryshimet që duhet të bëj për të shmangur konfliktin e interesit.

Znj. Kadriu - Ukelli ka deklaruar se me kalimin e saj në politikë e ka njoftuar pronarin e këtyre kompanive se ndërprejnë çdo aktivitet të saj në këto kompani ndërsa ato i kanë ofruar vendimet me shkrim me të cilat është shkarkuar për shkak të dorëheqjes. Ajo deklaroi se këto vendime i ka dërguar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), mirëpo ndryshimet nuk janë ekzekutuar për arsye që ajo nuk mund t'i shpjegojë.

Duke pasur parasysh këtë, AKK i ka dhënë një afat shtesë, por të kufizuar ligjor, për t'i sjellur ndryshimet.

Ndërkohë ajo ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, (DPKI 03-02-2651/15), të lëshuar nga ARBK, me të cilën vërtetohet se është larguar nga pozitat menaxheriale në tri bizneset private të përmendura më lart. Me këtë zyrtarja e lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

